

20070290434

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL ME FINANCIM TË
DETYRUESHËM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004 dhe 113/2005), në nenin 51 paragrafi (6) pas pikës e) shtohet pika e re zh) si vijon:

“zh) nëse në afatin prej dy tremujorëve të njëpasnjëshëm, Agjencia tregon rezultate negative financiare në punë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.